



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DHE TURIZMIT

BASHKIA DURRËS
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Durrës, më ____ . ____ .2019

Lënda : Formulari i Njoftimit të Fituesit

Për: Ofertuesin fitues TRINITY TRADE COMPANY Tiranë Njësia Administrative Nr.10, Rruga Alqi Boshnjaku (ish Rruga Reshit Çollaku), Ndërtesa Nr.38, Hyrja 6, Ap.1, Kodi Postar 1001.

Procedura e prokurimit: Proçedurë Kërkesë për Propozim

Numri i referencës së procedurës/lotit: : REF-29384-07-04-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës : “Blerje uniforma për Policinë Bashkiake”, me fond limit 1.563.000 lekë, sasia sipas preventivit, afati 30 ditë.

Publikime të mëparshme(*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike. [Nr.27 datë 08 Korrik 2019]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Denisa Beshaj

L41904011K

Vlera 1.253.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë

2. TRINITY TRADE COMPANY

K81630026U

Vlera 1.274.600 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind) lekë

3. EURO 2001

K13112202Q

Vlera 1.333.600 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind) lekë

4. Blerina Sadiku

K97730102T

Vlera 1.343.360 (një milion e treqind e dyzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë

5. MALBERTEX

K71821009N

Vlera 1.359.560 (një milion e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë

6. GJERGJEFI

J66702620Q

Vlera 1.497.800 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind) lekë

7. PAERA

L31505034R

Vlera 1.522.600 (një milion e pesëqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind) lekë

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Denisa Beshaj

L41904011K

2. MALBERTEX

K71821009N

3. PAERA

L31505034R

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Ofertuesi Denisa Beshaj me vlerë të ofertës 1.253.000 lekë nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentet e tenderit e konkretisht:

- Në DST, pika 2, "RITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT" është kërkuar:

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

dh.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Operatori ekonomik Denisa Beshaj ka paraqitur një vërtetim debie të datës 29/05/2019 ku vërteton se operatori ekonomik Denisa Beshaj i ka shlyer detyrimet për energjinë elektrike deri në muajin Prill 2019, por operatori ekonomik Denisa Beshaj e kishte të gjithë kohën e mjaftueshme që të shlyente detyrimet për energjinë elektrike, për muajt/muajin që i takon para datës së hapjes së ofertave.

2 - Në DST, pika 2.3 "Për kapacitetin teknik", gërma "a", kërkohet:

Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë prej 625'000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë

Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre ose/dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Operatori ekonomik Denisa Beshaj ka paraqitur fatura me sektorin privat, keto fatura rezultojnë të pasakta, pasi mungon NIPT_i Bleresit, element tatimor i detyrueshëm, kjo bie ndesh me DST, pikërisht në Shtojcën 8, ne fud të saj ku thuhet se: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim”. KVO i konsideron dokumenta të pasakta.

KVO vendos që ofertuesi të mos kualifikohet.

- Për ofertuesin MALBERTEX,

1- Gjate leximit të Formularit të Ofertës, sipas Shtojcës 1, KVO konstaton se ky ofertues ka deklaruar dy vlera oferte të ndryshme, një vlerë të ofertës në shifra 1.359.560 lekë, dhe një vlerë të preventivit 1.329.560 lekë.

2- Operatori ekonomik MALBERTEX ka paraqitur Shtojcën 2/1 “Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar”, por nuk ka klikuar një nga alternativat e pikes 6(*germen a ose germen b*) të kesaj shtojce. Në lidhje me keto pasaktesi në të dyja shtojcat e kërkuara në DST, referuar dhe Shtojcës 8, ne fud të saj, ku thuhet se: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim”. KVO i konsideron këto dokumente të pasakta.

KVO vendos që ofertuesi të mos kualifikohet.

- Ofertuesi PAERA me vlerë të ofertës 1.522.600 leke, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të keërkuara në dokumentet e tenderit e konkretisht:

1 - Në DST, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, gërma “a”, kërkohet:

Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë prej 625’000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë

Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre ose/dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet te paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Operatori ekonomik PAERA për furnizime të ngjashme, ka paraqitur dy fatura furnizimi, një faturë furnizimi me bashkinë Mirditë ku perfshihen kostume për policine bashkiake, në vlerën prej 435.000

lekë, një faturë me Qendrën Shëndetësore Nr.3 Tiranë për uniforma, përparse pune për qendrën, në vlerën prej 134.000 lekë, të cilat me vlerat e të dy faturave së bashku nuk plotësohet vlera 625'000 lekë për furnizime të ngjashme, kërkuar në DST, ndërsa në një folder me emertim: “Fature Furnizim Uniforma për Prokurorë” nuk ka faturë por dokument bosh, kjo bie ndesh me DST, pikërisht në Shtojcën 8, në fud të saj ku thuhet se: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim”.*

KVO vendos që ofertuesi të mos kualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se: Ofertuesi TRINITY TRADE COMPANY Tiranë Njësia Administrative Nr.10, Rruga Alqi Boshnjaku (ish Rruga Reshit Çollaku), Ndërtesa Nr.38, Hyrja 6, Ap.1, Kodi Postar 1001, oferta e të cilit është me një vlerë të përgjithshme prej 1.274.600 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind) lekë është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Durrës, Sheshi “Liria” Durrës, tel/fax 052222310, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29.07.2019.

Ankesa: ka ose jo __ Po __

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 01.08.2019, dhe me Vendimin e K.P.P. 626/2019 datë 26.09.2019

Titullar i Autoritetit Kontraktor

Zyrtari i autorizuar

Etleva Kondi